

KËRKIME GJUHËSORE

Brikena SMAJLI

NGA KËNGA E KËNGËVE TEK LETËRSIA KOMBËTARE

Poezia lirike është krijimi i parë i kulturës europiane, origjinat e së cilës i vendosim në kulturën helene. Orfeu, këngëtar / poet trakas, parahelen, mbahet jo vetëm si krijuesi i parë lirik, por edhe arketipi i poetit në kulturën europiane; ndërsa termi antik grek i poezisë dhe i poetit, nënkupton formësimin, krijimin si veprim dhe formësuesin, krijuesin si emërtim. Megjithatë, tek Orfeu nuk kemi vetëm poetin si krijues, por edhe atë transmetues të ritualit të Krijimit nëpërmjet ritualit të Mistereve orfike, themeluar prej tij, si edhe hymneve orfike, kënduar prej tij, të cilat, veç të tjerash, e kanë origjinën nga Lindja e Mesme, Egjipti. Simbioza e poetit si krijues dhe poetit këngëtar transmetues, ndeshet në kulturën europiane që në fillimet e saja, ashtu siç tek Orfeu prapë ndeshim edhe lidhjen e kryehershme poezi-religjion, poezi/krijim dhe Krijim, si edhe qasjen e poetit ndaj Krijimit, Natës dhe Vdekjes.

Nga ana tjetër, vetë popujt e Lindjes së Mesme, kulturat semite, kultura jo vetëm shkrimore e të cilëve është pjesë e qenësishme e kulturës europiane sot edhe në poezi, përdor tjetër shënues për poetin dhe poezinë. Në gjuhën arabe fjala "Shi'ir" شاعر, hebraisht "Shir" שִׁיר do të thotë "me ndie" dhe "me shprehë ndienjë"¹ dhe është emërtimi semit i poezisë. Kjo fjalë vjen nga akadishtja "Shiru",² e cila, siç thonë specialistët e gjuhëve të vjetra të Mesopotamisë, ka një kuptim të dyfishtë. Ajo përkton me dy folje: e para "surakhu" nënkupton "me qâ"; e dyta është "zammuru" që nënkupton "me këndue. שִׁיר הַשִּׁירִים (Shir Hashirim) është për hebrejtë "Kënga e këngëve".³

شاعر: اداع، نشر - راجع اشاع	
poet	شاعر: ناظم الشعر
poet laureate	شاعر البلاط
feeling, sensing; perceiving,	شاعر ب: يُحِسُّ ب، يَذْكُر

¹ Al-MAWRID, A Modern Arabic-English Dictionary, Dar El-Ilm Lilmalayin, Beyrut, 1995, f. 701.

² The Gateway to Modern Arabic Poetry, translated by Munir Mezyed (Romania) & Prof. Abdul-Settar Abdul-Latif, Al-Assady (Iraq), Ed. Abdul-Settar Al-Assady, Art-GatE Association, Romania, 2007. Introduction. f. 311. Siç tregojnë një numër i madh kërkimesh arkeologjike, gjuha akade është një gjuhë shumë e ngjashme edhe pse jo, paraardhëse me arabishten, në të gjitha nivelet gjuhësore: sintaksë, morfologji, fonologji dhe semantikë.

³ The Gateway to Modern Arabic Poetry, translated by Munir Mezyed (Romania) & Prof. Abdul-settar Abdul-Latif, Al-Assady (Iraq), Ed. Abdul-Settar Al-Assady, Art-GatE Association, Romania, 2007. Introduction. f. 311.

Vetë *Kënga e këngëve*, bart një shënues të veçantë në lidhje me poetin dhe poezinë si edhe me Krijuesin. Ajo mishëron nocionin e këngë-vajit shpirtëror. E konceptuar si këngë dasme, si epitalamet për të cilat mund të mburret qytetërimi helen me Safon, *Kënga e këngëve* nuk mohon as marrëdhënien me këtë traditë, as modelin zanafillor të formatit Qiell-Tokë, në një martesë të shenjtë, botkrijimin. Ndryshe nga tradita paraprijëse, *Kënga e këngëve*, e emërtuar edhe si Martesa e martesave⁴, apo dashuria e dashurive dhe krijimi i krijimit, nuk ka shenjues individualë të *Të dashurit* dhe *Të dashurës*. Pavarësisht nga shenjuesit kohorë nga historia hebraike (Detin, malin Sinai, çlirimin e parë nga Egjipti, të dytin nga Babilonia) shtrirja gjithkohore edhe në këtë drejtim, krijon për këtë poemë idenë e pakohësisë...gjë që ka nxitur jo pak interpretime në lidhje me të. Konceptin e Tokës dhe të Izraelit e përforcon edhe fakti se dashuria i drejtohet jo një të dashurë të personalizuar Shulamite, por emërtohet sipas stinëve (verë, vjeshtë, pranverë, dimër). Kemi të bëjmë me një dashuri *pranverë*,⁵ siç paraqitet në vargjet e mëposhtme: *10 Ja, i dashuri im po më thotë: / “Çohu, mikesha ime, /pëllumbesha ime, bukuroshja ime dhe eja! / 11 Se tashmë dimri mbaroi, / pushoi shiu edhe kaloi! / 12 U mbulua toka me lule, / e të kimit koha arriti, / turtullit i ndihet zëri në vendin tonë...*⁶

Tradita rabinike (v. 70 të e.s.)⁷ prej së cilës kjo këngë është transmetuar edhe në truallin europian e shpjegon si Dashuria e Zotit abrahamik me Tokën izraelite a Izraelin (Judaizmi) dhe Krishtërimi e lidh në Dashuri Krishtin me Kishën. Modeli dhe leksiku erotik, i cili nuk duhet mohuar në këtë këngë, i jep intensitet pasionit të dashurisë, pa mbërritur përmbushje, por duke plotësuar pikërisht emërtimin e saj si *këngë e këngëve*, si *dashuri e dashurive* a si *martesë e martesave*. Realizimi si i tillë, në mungesë të këtij intensiteti erotik e dashuror dhe, paraqitja e purifikuar në këtë drejtim e leksikut, do të bënte veçse të pangjashëm veprimin e pasionit, asaj që poeti këngëtar e përruron si këngë e vaj shpirtëror, si edhe të pamotivueshme *Këngën e këngëve* / Pasionin e pasioneve etj. Këngët janë

⁴*Interaction between Judaism and Christianity in History, Religion, Art and Literature* edited by Marcel Poorthuis, Joshua Schwartz, Joseph Turner, (Jewish and Christian perspectives series ; v. 17) Koninklijke Brill NV, Leiden, The Netherlands, 2009, Tamar Kadari, A three-level interpretation of song, f. 70. “In the prologue to his Commentary and in the opening of the first Homily, Origen explains that the Song of Songs is a marriage-song, an epithalamium (Origen Cant, Homilies 268) presented in the form of a drama (Origen Cant, Commentary 21–22).

⁵ Po aty, f. 112.

⁶ Bibla, Kantiku i Kantikëve: 2. Unë jam lule e çelur në fushë, 2.10-13.

⁷ Encyclopedia of world history, edited by Marsha E. Ackermann... [et al.]. Includes bibliographical references and index, Facts On File, 2007. f. 80, Christian, early.

“Christianity grew out of Second Temple Judaism and inherited its most important legacy, the Jewish scripture. It also inherited much of the Jewish interpretive traditions, such as the concepts of monotheism, covenant, election, and revelation, that had shaped the interpretation of these scriptures.”

quajtur ndryshe edhe të Solomonit⁸ dhe shmangia e autorësisë nga ana e poetit përkon jo me një trill të thjeshtë letrar⁹, por me natyrën semite të poetit, të cilit nuk mund t'i jepen cilësi krijuese, ashtu siç qëndron po i motivuar fakti që emërtimi dhe përmendja e Zotit abrahamik është e pamundur.

Subjekti dhe këndvështrimi i tyre na paraqet zhvendosjen nga koncepti krijues a qasës ndaj Krijimit dhe Krijuesit, në atë të një misterit tjetër krijimi: ndjenjës si vullnet jetësor dhe krijues, njerëzor. Këngët, para së gjithash paraqiten si ndjenjë në veprim, pasion, dashuri. Kështu, teksti biblik i këngëve u sjell një përmasë të re këngëve të dasmës edhe në traditën e mëparshme semite: atë shpirtëror dhe hyjnor, duke vendosur kështu konceptin e dashurisë në themel të idesë mbi Krijuesin dhe Krijimin si edhe mbi vetë poetin. Në krahasim me poetin si krijues, trillues nëpërmjet modelit apo gjasave, vargëzimi semit paraqet poezinë si ndjenjë (këngëvajt) dhe ndjeshmëria kundrejt Ngjarjes, edhe si përjetim, është e vërtetë. Kështu vihen përballë dy koncepte mbi lirikën si poezi - krijim, trillim, përfytyrim, fantazi, e bukur dhe lirikën si ndjenjë të Vërtetë. Por ndërsa fantazia, trillimi, e bukura janë kategori estetike; e vërteta është kategori etike.

Në poezinë fetare edhe predikimin fetar, lutjen, proverbat, Këngën e këngëve, koncepti i të vërtetës, është i lidhur me misterin e Krijimit dhe Krijuesin dhe, përjetimi ndjesor i *udhëtimit* drejt tij (Krijimit dhe Krijuesit) është i vërtetë dhe i bukur. Për më tepër, ndërsa koncepti helenik dhe europian e konsideron poetin si krijues, origjinal dhe të përveçuar, duke vendosur këtë paralele me Krijimin, qoftë si tekst (marrëdhënie simbolike, alegorike dhe ndërtekstorësie); qoftë si individ krijues (marrëdhënie profane, gnostike dhe transmetuese-profetike) me Krijuesin; tradita semite dhe besimet monoteiste, (Judaizmi dhe Krishtërimi, më vonë edhe Islami) do të përurojnë një koncept të poetit si *Shir / Shair*, i cili në këngë-vajin e tij kërkon ta përjetojë dashurinë hyjnore nëpërmjet asaj njerëzore dhe të lartohet, nëpërmjet dashurisë, deri në nivelin e Fjalës që *ishte në Hyjin*, që është e Vërteta, Dritë e Jetës, Dije. Sado që koncepti ynë mbi të bukurën në artin poetik, do t'i shmanget apo do të përjashtojë të vërtetën, të

⁸ Bibla, përkthim dhe shtjellim nga Dom Simon Filipaj. Besëlidhja e vjetër, Kënga e këngëve, I “*Kënga e këngëve e Salomonit*” versioni hebraik i përcakton si të tilla: të Solomonit. (אֲשִׁיר הַשִּׁירִים, אֲשִׁיר לְשֹׁלֹמֹן) - shih Bible Annotée, ou Bible de Neuchâtel, L’Ancien Testament HÉBREU – FRANÇAIS, Soleil d’Orient, 2005, f. 2560.

Carlo Ghidelli, “Due Storie d’amore”, vol. 24, “Per Capire la Bibbia”, “Ave”, Roma, 1994, f. 18). “Bibla saktëson se libri është shkruar nga Salomoni...por ekspertët mendojnë se këtë vepër e ka shkruar rreth shekullit të IV (p.e.s.) një poet i madh dhe i panjohur, i cili, siç ishte zakoni në botën e lashtë, duke vendosur veprën nën autorësinë e një personazhi të famshëm, ka dashur t’i jap asaj autoritet më të madh.”

⁹“Bibla”, përkthim dhe shtjellim nga Dom Simon Filipaj, vep. e cit., f. 876). “Megjithëse në libër pohohet se është kënga e Salomonit, të gjithë pohojnë se autori është i panjohur dhe fshihet nën pseudonimin si të ishte Salomoni. Dihet se ky është një trill letrar, sepse vetë fjalori me shumë aramaizime e fjalë persiane na siguron se duhet të jetë krijuar shumë kohë pas Salomonit” (“Bibla”, përkthim dhe shtjellim nga Dom Simon Filipaj, vep. e cit., f. 876).

moralshmen, të drejtën; përjetimi ndjesor dhe i vërtetë i Ngjarjes / Krijimit apo përkushtimi deri në ngazëllim i besimtarit edhe në lutjen e tij të thjeshtë, nuk mund të jetë ndryshe, përveçse i bukur. Vështrimi prej kësaj qasjeje i poezisë-lutje fetare edhe pse i përgjigjet një tjetër natyre mbi krijimin artisti - në fakt as që e synon një gjë të tillë - është vështrim edhe mbi artin, poezinë si krijim.

Metafora fetare, rrokja e së cilës kuptimisht përkon me përjetim shpirtëror e të vërtetë, është art në veprim i cili “gjallërohet” në sajë të lidhjes së njëmendtë dhe të vërtetë të predikuesit, besimtarit dhe Idesë, ndër të cilët edhe si metaforë, modeli parësor i krijimit biblik të Besëlidhjes së re, i jep poezisë përmasën mistike, në elementin më qenësor të saj, Fjalën.

Gjoni: 1. Mishërimi i Fjalës

1.1 Në fillim ishte Fjala e Fjala ishte në Hyjin e Fjala ishte Hyj.2 Kjo ishte në fillim në Hyjin.

3 Prej Saj u bë çdo gjë e pa Të nuk u bë asgjë. E çdo gjë që u bë, 4 e pati në Të jetën e Jeta është drita e njerëzve; 5 e Drita shndriti në errësirë e errësira nuk e pushtoi.6 Qe një njeri i dërguar prej Hyjit. Emri i tij ishte Gjon.7 Ai erdhi si dëshmitar, për të dëshmuar Dritën, që të gjithë të besojnë nëpër të. 8 Ai nuk ishte Drita, por - për të dëshmuar Dritën.9 Drita e vërtetë që shndrit çdo njeri, erdhi në botë.10 Ishte në botë e bota u krijua prej Saj, e bota nuk e njohi.11 Erdhi ndër të vetët, e të tijtë nuk e pranuan.¹⁰

Koncepti i të vërtetës, që synohet të përjetohet me dashuri (si ndjenjë e pastër dhe jomateriale) drejt të cilit “udhëton” këngëtari-poet, është Natë (mister) - Lejla dhe është Dritë (dije, e vërtetë) dhe Vdekje (shkrirje, çtrupëzim, lartësim).

Në Bibël ideja e një Zoti dhe Krishtit, që vdes në kryq për mëkatet e njerëzimit, e predikuar nga apostulli Pal, është shprehëse e një mendësie të re kundrejt Judaizmit dhe antikitetit dhe e vendos edhe dashurinë në zemër të Besëlidhjes së re njerëzim-Hyj.¹¹ 6 Dhe njëmend, ndërkohë, kur ne ishim të pafuqi, Krishti, në kohën e duhur, vdiq për keqbërësit. 7 E pra, vështrë do të pranonte kush të vdesë për një njeri të drejtë - ndoshta për ndonjë njeri të mirë ndokush edhe do të merrte guxim të vdesë. 8 Por Hyji e dëftoi dashurinë e vet kundrejt nesh kështu: ndërsa ne ende ishim mëkatarë, Krishti vdiq për ne. 9 E pasi tani ne jemi të shfajësuar me anë të gjakut të tij, është më se e sigurt se ai do të na shpëtojë nga dënimi.¹²

Figura e një Zoti që vdes në kryq, me dashuri për mëkatarët, është një transcendencë dhe vlera ideale, absolute e dashurisë, për këtë edhe përruese e një

¹⁰ Bibla, Gjoni: 1. Mishërimi i Fjalës, 1.1-16.

¹¹ Encyclopedia of world history, edited by Marsha E. Ackermann... [et al.]. Includes bibliographical references and index, Facts On File, 2007. f. 80 “Armed with this conviction, Paul redefined Jewish monotheism in new and surprising ways. If God had chosen to reveal himself fully in the death of Jesus, Paul argued, God, like Jesus, must be a friend of sinners. “God shows his love for us in that while we were yet sinners Christ died for us”(Rom. 5:8; Revised Standard Version).

¹² Bibla, Besëlidhja e vjetër dhe Besëlidhja e re, Drita, Ferizaj 1994, përktheu Dom Simon Filipaj. (Romanëve, Adami dhe Krishti 5:6-9).

besimi të ri ndaj botës antike,¹³ përballë së cilës triumfon, pikërisht, me dashurinë, flijimin, përlulen, pastërtinë, të mirën...

Pikëmbërritja në qëllim nëpërmjet dashurisë për tek Nata, Drita dhe Vdekja është udhëtim për tek Krijuesi, si përjetim, njohje, pranim edhe i vetes.

Duke sjellë në mend edhe një herë *Këngën e këngëve*, përrurimi i dashurisë së të cilës është sublim dhe i shembullëzuar edhe më pas në Besëlidhjen e re në figurën e Krishtit, provojmë të kuptojmë e hetojmë rolin e poetit / profetit a apostujve, të cilët përballë Ngjarjes / Krijimit paraqiten të depersonalizuar, jo individualë, anonimë, për sa kohë që vetë dashuria e Hyjit i mund në madhështi dhe përluje. Zoti abrahamik është i lartë, qiellor, i gjithëdijshëm dhe, për më tepër, është *frymë që endet mbi ujëra*, i pa formë dhe i pambërritshëm, krijues nëpërmjet Fjalës, mendimit; krijues për shkak të dashurisë.¹⁴

Tradita e predikimit dhe e vështrimit të Zotit si dashuri, thelbi i të cilit mbërrihet vetëm me dashuri është një traditë jo pa vazhdimësi edhe në letërsi. Kuptohet, para së gjithash përmendim këtu traditën rabinike, si edhe atë transmetuese të apostujve, etërve të Kishës, vepra e të cilëve kundrejt tekstit biblik ka vetëm, vlerën e transmetimit, komentimit, deri edhe atë të përkthimit, por jo të krijimit. Bibla, ndërkohë nuk merret si tekst poetik, pavarësisht vlerës së padiskutueshme edhe poetike dhe letrare të saj; ajo si e tillë i përgjigjet konceptit të të vërtetës / Vërtetës, në zemër të së cilës është ditë-nata.

Një traditë e tillë në vijimësi gjen shfaqjen e vet qoftë në poezinë sufiste, Hallaxhi, Rumi... ku esenca e Zotit është dashuria, *masnavitë* e të cilëve janë në thelb interpretime, brenda formatit të gjuhës biblike a kuranore; qoftë në traditën e shenjtëve kristianë, si edhe mistikëve kristianë, ndër të cilët përmendim Ramon Llull-in, por edhe trubadurë si Arnaut Daniel-i¹⁵. Një formati të tillë poetik i përgjigjet Dantja, i cili në "Komedinë hyjnore" (1308-1321) nis një kërkim / udhëtim për lartësim shpirtëror, dije e të vërtetë, i frymëzuar nga dashuria e Beatrices, e cila, paraqitet si simbol i dëlirësisë dhe është lartuar deri në nivelin e Parajsës aq sa të projektojë një surprizë për poetin. Petrarka nga ana e tij në sonetet mund të lexohet në këtë model dashurie. Kultura europiane e shkrimit poetik, modelin biblik e shembëllzon në një këndvështrim alegoriko-simbolik tek

¹³Encyclopedia of world history, edited by Marsha E. Ackermann. [et al.]. Includes bibliographical references and index, Facts On File, 2007. f. 81.

¹⁴ Shih, Bibla, Besëlidhja e re, Gjoni, 1. 4, 7 Hyji është dashuri (përkthim i Dom Simon Filipaj) 7 Të dashur, ta duam njëri-tjetrin, sepse dashuria vjen nga Hyji, dhe, secili që ka dashuri, ka lindur prej Hyjit dhe Hyjin e njeh. 8 Kush nuk ka dashuri, nuk e ka njohur Hyjin, sepse Hyji është dashuri. (...)15 Kush dëshmon se Jezusi është Biri i Hyjit, Hyji mbetet në të edhe ai në Hyjin. 16 Ne e njohëm dashurinë që Hyji ka kundrejt nesh dhe i besuam asaj. Hyji është Dashuri, dhe, kush mbetet në dashuri, mbetet në Hyjin dhe Hyji mbetet në të. 17 Në këtë përmbahet përsosmëria e dashurisë ndaj nesh: kemi sigurinë e plotë për Ditën e Gjyqit, sepse, siç është Ai, jemi edhe ne në këtë botë. 18 Frikë në dashuri nuk ka, sepse dashuria e përsosur e përjashton frikën, pse frika nënkupton ndëshkimin. Pra, ai që trembet, nuk është i përsosur në dashuri. 19 Ne duam sepse Ai na deshi më parë.

¹⁵Ruud, Jay. Encyclopedia of Medieval Literature, Fact on File, 2005, f. 38.

Toka (atdheu), Fjala (gjuha kombëtare, por edhe dija), Dashuria (Kisha – krishtërimi), njerëzit.

Veprimi i Ramon Llull-it, pak dhjetëvjeçarë para Dantes, tek përfundon novelën e parë europiane *Blaquerna* (1283) dhe në të përfshin "*Llibre d'amic e d'amat*"¹⁶ (*Librin e të dashurit për të dashurin*) nuk është gjë tjetër veçse përgjigje e të njëjtës skemë mbi botkrijimin apo përjetimin ndjesor të Krijimit dhe Krijuesit, duke mos e përsëdytur atë me veten si poet/krijues, po pikërisht në nocionin e këngëvajt të shprehur në "Këngën e këngëve". Libri ka 365 poezi dashurie, të cilat vijnë si rrëfim mistik i protagonistit, bazuar në traditën sufi dhe, sidomos, në atë të Mansur Al Hallaxhit, si një qasje meditative kundrejt utopisë apostolike dhe me synim një reformë në krishtërimin e kohës.

26. "Këndonin zogjtë agimit dhe u zgjua dashnori: është agimi. Dhe zogjtë pushuan së kënduari dhe dashnori vdiq për të dashurin në agim."¹⁷

228. *Dashuria është një det i trazuar nga valët dhe erërat, që ledhaton portin dhe veshët. Vdes dashnori në det, e, në rrezik të tij, vdesin të tijat mundime dhe lindin të tijat përsosmëri.*¹⁸

Vetë libri është shkruar në gjuhën katalane dhe është krijimi më i parë në këtë gjuhë si edhe qasje e modelit kristian në dashurinë mistike dhe interpretimin e Biblës përkundër natyrës sufije të interpretimit kuranor. Ai si veprim krijues nuk është dhe as paraqitet si poezi (krijim, formësim), por është përjetim mistik i Natës, Dritës dhe Vdekjes.

Në marrëdhënie me këtë poetikë si edhe me poetikën e krijimit, ndërsa fillimet e poezisë së shkruar shqipe dokumentohen më vonë se pjesa më e madhe e kulturave poetike shkrimore europiane, veçori është fakti se vargëzimi shqip fillon i lidhur ngushtë me religjionin (poeti është transmetues edhe pjesë e Tërësisë dhe, për më tepër edhe si transmetues e persiatës i Krijimit si frymë dhe transmetim i tij.) me paratekst biblik dhe krishterimin. Pasja në sistemin poetik shkrimor të figurave të tilla si P. Budi, P. Bogdani, J. Variboba, Matrënga, P. Zarishi, të cilët përkushtueshmërisht i përgjigjen kësaj poetike të krijimit, merr në poezinë shqipe një rëndësi të veçantë. Ajo përcakton jo pak edhe natyrën e poezisë dhe të poetit shqiptar. Lidhja me tekstet biblike është ligjërimore dhe tematike.¹⁹ Parë në këtë këndvështrim letërsia, poezia shqipe në fillimet e saj është poezi e religjionit, ka paratekst Biblën ose librat e saj, është interpretim, përkthim, përshtatje, pa

¹⁶ Llull, Ramon. *Libro de Amico y Amado*, traduccion y prologo de Eduardo Moga, Dvd Ediciones/ Editorial Barcino, Barcelona, 2006. f.16 Prologo Poesia que no pretendia serlo.

¹⁷ Llull, Ramon. *Libro de Amico y Amado*, f. 48/49. Përkthimet janë të autores së punimit (B.S) Versioni është dygjuhësh prandaj faqet janë dhënë në dy faqet përkatëse, ku ndodhet teksti në gjuhën katalanase dhe atë spanjolle.

¹⁸ Llull, Ramon. *Libro de Amico y Amado*, f. 162/ 163.

¹⁹ S. Hamiti, Vetëdija ...f. 16. "Letërsia e jonë e shkruar që nga fillimi dhe për disa shekuj është mbështetur në kodin biblik, njëherë si përshkrim e tejshkrim, më vonë si shkrim në gjirin e tij dhe si përngjasim me të. Në shek. XVI dhe XVII, që është bërë zakon të quhet letërsi e vjetër shqipe lidhjet me tekstet biblike janë edhe të natyrës tematike edhe të natyrës ligjërimore".

mbërritur tek Krijimi si poezi. Për sa i përket rëndësisë, teksti biblik është Ngjarja, e vërteta ndaj së cilës shëmbëllesa e tekstit shkrimor priret. Në një kontekst tjetër teksti biblik përbën një kulturë shprehjeje dhe qëndrese, është filozofi e ekzistencës kombëtare, përruron një gjuhë lokale me Fjalën dhe motivohet nga dashuria. “*En feh dafunit seh boteffe faneh*” (Buzuku).

Kulti i Fjalës, përjetohet qoftë në nivelin mistik të Dijes, Dritës, Të vërtetës si religjion, qoftë si akt atdhedashurie, i cili shembëllzohet në dheun, tokën, gjuhën. Përjetimi dhe imazhi biblik arrin të sendërtohet dhe të transmetohet si i tillë. Nga pikëpamja e Modelit gjuhësor si Ngjarje, qasja ndaj Biblës është e drejtpërdrejtë dhe e vërtetë. Teksti predikues, komentues dhe përkthimi a përshtatja, përjetohen me këtë synim. Vetë autorët, në rolin e përmbledhësit, komentuesit a përkthyesit e përjetojnë procesin e përgatitjes së veprës jo me qëllim krijues dhe përveçues, por në vazhden e misionit dhe funksionit të përgjithshëm. Tekstet poetike, sidomos ato mbi Krijimin: Krijimi i Rruzullit, Krijimi i rruzullimit, ndërsa shquhen për përpunimin e gjuhës në drejtim të qasjes sa më të plotë ndaj modelit biblik, nuk priren drejt një personalizimi autorial.

*Mboh nuk i bie, se nukë permetonj me n'xjerrë me këtë fëtigë kafshë të re, tue kjanë mirë ndë kafshë të fesë me u larguem prej se i kanë të tjerë mpsuem e kallzuem,*²⁰ - thotë Bogdani në *Të primitë perpara letërarit*.

Vlera krijuese e poezive të Budit dhe Zarishit qëndron në mjeshtërinë e gjuhës së përpunuar dhe ndërthurjen funksionale të metrave dhe ritmikës ligjërimore të traditës biblike me ritmet e shprehite popullore. Gjuha, Dheu (atdheu) janë të identifikuara me Kishën (Krishtin), ashtu siç vetë ndodh me Vetë uni lirik është i zhytur në tekst. Dallimi thelbësor në qasjen ndaj poezisë dhe poetikës ka të bëjë me individualitetin poetik, prej këndeje edhe origjinaliteti apo përveçimi. Për mendësinë lindore, poeti ende ruan sharmin impersonal (jo personal) të qenies njerëzore, plotësisht i frymëzuar nga Hyji, dhe në çastin e shkrimit, është ndërmjetësi i fjalës së Tij. Për poetin shqiptar, përveçimi merret rëndom si shenj mallkimi apo tejkalim kufijsh në raport me tërësinë (kombin, atdheun). Shtati i një letërsie / poezie, e lindur si misionare, arrin rrallë të tejkalojë paratekstin nga Krijuesi tek poeti.

²⁰ Bogdani, *Të primitë perpara letërarit*, Cuneus prophetarum, f. 28.